




NË PROMOVIM
TË NUMRIT 150
TË GAZETËS "UDHA ISLAME"



KUR NJE EMOCION
MUND TE KTHEHET
NE DEVOCION




DITA E ASHURES
DHE MESAZHI I SAJ

Viti XIII - Nr. 10 (152),
Tetor, 2015

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Zotit të vetëm të botëve, i Cili e udhëzoi njeriun në më të mirën e mënyrave, nëpërmjet shpalljeve të Tij hyjnore. Thotë në Kur'anin Famëlartë: “Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.”¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta, ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhamedit (a.s), që u dërgua me moralin më të lartë, udhëzim dhe shëmbëlltyrë për krejt kërkuesit e udhëzimit. Për këtë, Zoti i gjithësisë i drejtohet duke i thënë: “Vërtetë, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”²

TË NDERUAR DHE TË DASHUR BESIMTARË,

Dita-ditës, jeta e njerëzve po mbushet me halle, dëshpërim, stres e ankthe pa fund, që burojnë nga mungesa e sigurisë, dobësimi i ekonomisë, përhapja në masë e mashtrimit, gënjeshtërisë, imoralitetit, shthurjes, thashethemnajes, humbjes së kohës, angazhimit të personit me atë që nuk e di dhe marrja përsipër e të gjitha gjërave, deri në fé, ku dikush është i interesuar që rinia e jonë të mos ketë edukatë, të mos njohë kufij, të mos respektojë më të diturin e më të rriturin, të mos frenohet para disiplinës etj.

Përditë e më shumë, nëpërmjet medias, po na imponohen raste të

“E ÇFARË TË NDODH, NËSE NJERËZIT TË SHAJNË, NDËRKOHË QË TEK ALL-LLAHU JE I LAVDËRUAR?”

islamofobisë dhe nxitjes së urrejtjes fetare dhe krahinore, si rasti flagrant i thirrjeve raciste dhe osmanofobe (thua islamofobe), që quan deri në atë veprim të degraduar të prishjes së një pllake historike në një prej kalave të vendit tonë, në qytetin ku xhamia Selimije e prishur dhe e shndërruar nga të kuqtë, nuk u kthye më kurrë në identitetin e saj legjitim!?

Është dëshpëruese të mendosh se akoma sot, në vitin 2015, vendi ynë, me gjithë këto mirësi dhe begati të panumërta që i ka dhënë Zoti, të vuajë e të rreshtohet në listën e vendeve pa shpresë, pa dritë, pa jetë!

Para dy netësh, teksa kthehesha nga Stambolli, në momentin e zbritjes në aeroportin e Rinasit, një turist i huaj, që po bashkëbisedonte me një pasagjer bri meje, i drejtohet dhe i thotë: “Shqipëria është Kuba e Evropës!”...

Nga statistikat e shumta, që kalojmë nëpër duar, dëshmohet se tek ne po rritet numri i divorceve, po shtohet numri i aksidenteve me shkak dehjen, po rritet numri i kumarhaneve, po shtohet numri i konsumuesve të alkoolit dhe mishit të pakontrolluar, sidomos atij të derrit. Ka kohë që dëgjojmë për shtimin e përdoruesve të drogave të ndryshme, mbrëmjeve të përziera me muzikë e pije alkoolike, aborteve të panumërta, degjenerimit...

Pyetja është e thjeshtë: Nga po e çojnë këtë vend dhe përse njerëzit tek ne po e lejojnë veten të rrëshqasin në greminat e dekadencës morale e shpirtërore, duke u larguar edhe më shumë nga Zoti, sesa në kohët e errësirës ateiste?!

TË DASHUR TË PRANISHËM,

E kujtoj shumë mirë, si sot e rreth njëzet vite më parë, kur m'u kërkua të bëj një hytbe xhumaje në xhaminë e fshatit Bërdicë e Mesme. Isha shumë i ri, pa dije e kulturë të mjaftueshme për të kryer këtë detyrë. Asokohe, Myftinia Shkodër nuk kishte kuadro fetarë, nuk e kishte luksin të kishte edhe një sasi teologësh, që preferojnë të jenë dëgjues, para obligueshmërisë

*ËSHTË DËSHPËRUESE
TË MENDOSH SE AKOMA
SOT, NË VITIN 2015,
VENDI YNË,
ME GJITHË KËTO MIRËSI
DHE BEGATI TË PANUMËRTA
QË I KA DHËNË ZOTI,
TË VUAJË E TË RRESHTOHET
NË LISTËN E VENDEVE
PA SHPRESË, PA DRITË,
PA JETË!*

morale e fetare për të mbajtur të gjallë minberet e xhamive, ku hytbe mbajnë edhe njerëz që nuk e kanë formimin e duhur për të ngjitur shkallët e minbereve..?!

Iu drejtova Hoxhës tim, H. Vehbi S. Gavoçit, të cilit i kërkova ndihmë. Ai, rahmet pastë, buzëqeshi, më dha kurajo dhe pasi mori një defter të madh dhe një lapsë, nisi të shkruante, pa folur. Pas pak minutash, letra e bardhë ishte zbukuruar me shkrimin e Hoxhës. E ruaj edhe sot atë letër. Në të kishte shkruar një hadith, të cilin e përfundonte me shenjën “B”, dmth, Bukhari. (Ato ditë, nuk e dija se kush ishte Imam Bukhariu, as domethënien e asaj shenje).

Pasi ma dorëzoi, nisi ta lexonte bashkë me mua, që të ma mësonte dhe ta kisha të lehtë ta lexoja. Më tha: “Lexoje këtë hadith, do të mjaftojë!”.

Dhe nisëm të lexonim të dy: “Shtatë lloje njerëzish do të jenë nën hijen e Arshit të All-llahut, atë ditë kur nuk do të ketë hije, përveç hijes së Tij: Prijësi i drejtë. Një i ri që është rritur me frymën e adhurimit të All-llahut. Një burrë, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Dy burra, që janë dashtë për hatër të All-llahut; janë takuar e ndarë në këtë gjendje. Një burrë, që e fton një grua me pozitë e bukuri, ndërsa ai i

1. Kur'ani, El-Isra: 9.

2. Kur'ani, El-Kalem: 4.

përgjigjet: “Unë i frigohe All-llahut!”. Një burrë që jep një sadeka, të cilën e fsheh, sa e majta e tij të mos dijë ç’ka dhënë e djathta. Dhe, një burrë, që përmendë All-llahun në vetmi, derisa i mbushen sytë me lot”³

Subhanall-llah, sa madhështor është ky hadith! Sa mirësi dhe udhëzime përmban në thelbin e tij! Sa zgjidhje për problemet e të sotmes dhe garanci për të ardhmen, ofron!

TË DASHURIT E MI,

Ky është mesazhi i kësaj jave, që dua ta ndaj me ju. Ky është një mesazh që duhet t’ia mësojmë fëmijëve dhe rinisë tonë. Fillimisht, drejtësia në jetë.

Po lexoja mbi historinë e osmanëve në raport me trojet shqiptare. Gjeta edhe këtë ferman të datës 22 gusht 1595, ku thuhet se pasi [Sulltani informohet se dhjetë mijë kryengritës shqiptarë në krahinat e Dibrës dhe të Tetovës, nuk paguajnë detyrimet dhe qysh prej tre vjetësh kanë sulmuar autoritetet shtetërore... urdhëroi beun e Dukagjinit: “... Në rast se ata nuk i përgjigjen ftesës, të marshoni kundër tyre, të kapen rebelët dhe të ndëshkohen ashpër sipas sheriatit. Të ruheni që me pretekst, të mos dëmtoni, të mos persekutoni dhe të mos grabisni sendet e mallin e atyre njerëzve, që qëndrojnë në punët e veta”]⁴ Drejtësia!

Së dyti, edukimi i fëmijëve dhe rinisë me dashurinë për Zotin dhe besimin në Të. Mos të kemi ndrojtje me marrë fëmijët me vete në xhami. Të edukohen se xhamia është vendi i tyre. Ta duan xhaminë, të rriten në besim, nëpërmjet moralit dhe cilësive të besimit. T’i lutemi All-llahut për fëmijët tanë, të rriten me besim e të forcohen në besim. Ky moment më kujton Aliun, të birin e Fudejl ibn Ijadit, që i thoshte të atit: “O babë, lutju Atij që më ka bërë dhuratë për ty në këtë botë, të më bëjë dhuratë për ty edhe në Ahiret!”⁵

Së treti, lidhja e zemrës me vendin e adhurimit. Mos hezitoni me ardhë në xhami edhe jashtë xhumasë. Shëtitni nëpër xhamitë e lagjeve. Faluni ngado.

3. Transmetuar nga Bukhari dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

4. Petrika Thëngjilli, “Ligji dhe drejtësia në fermanet”, në botimin me titull: “Nga perandoria osmane në Shqipëri, e shkruar historinë me tolerancë”, Tiranë, 2005, f. 18.

5. Ibn Kudame El-Makdisi, “Er-rikkatu vel-bukau”, botimi i tretë, 2014, Damask, f. 357-358.

Merrni me vete edhe dikë në xhami. Mos t’i shkatërrojmë xhamitë tona me mosprezencën tonë. Se, çfarë kuptimi ka prezenca e xhamisë, kur t’i nuk hyn asnjë vakt në javë a muaj në të?

Së katërti, pjekuria në besim. Është bukur, kur sheh burra me thinja të bardha në xhami. Janë burim respekti dhe nderimi, janë burim mirësie për shoqërinë. Janë të pjekur në besim dhe model për më të rinjtë! Pjekuria, si ajo e Fudejl ibn Ijadit, që thoshte: “Nëse mundesh të mos njihesh fare, bëje! E çfarë të ndodh, nëse mbetesh i panjohur? E çfarë të ndodh, nëse nuk të lavdëron askush? E çfarë të ndodh, nëse njerëzit të shajnë, ndërkohe që tek All-llahu je i lavdëruar?”⁶

Së pesti, ndërtimi i marrëdhënieve shoqërore në mes vete, për hatër të Zotit dhe me qëllim fitimin e pëlqimit të Tij, jo hiles, interesit egoist, mashtrimit, gënjeshtërisë, abuzimit!?

Na rastis shpesh, të zhgënjehemi nga njerëz që kërkojnë bashkëpunimin tonë dhe ndërmjetësojnë pamjen e tyre të jashtme. Vëllezër, muslimani nuk e shet fenë e tij, namazin e tij, mjekrën, tespihët, fjalët e bukura me terma fetarë, vetëm e vetëm për t’u dukur e për të përfituar abuzivisht!? Ky quhet mashtrim dhe muslimani nuk mashtron!

Së gjashti, ndershmëria dhe mos animi nga epshet dhe tundimet momentale të shejtanit, që mund të lënë brenga të pakorrigjueshme për tërë jetën! Lexoni historinë e Hz. Jusufit (as), të riut të pashëm, për të cilin, gratë e mahnitura thanë: “All-llahu i qofshim falë! Ky nuk është njeri, ky nuk është tjetër vetëm se ndonjë melek i lartë!”⁷ Ndërsa ai, teksa ftohej për imoralitetin i lutej Zotit duke thënë: [Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dëshiruar për mua, se sa atë që ma ofrojnë ato dhe, nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të anoj nga ato e të bëhem injorant”]⁸ Injorancë!

Së shtati, bamirësia dhe kontributi në shoqëri, pa qëllime dukjeje a egoizmi.

Disa ditë para Kurban Bajramit të sivjetësh, një motër e nderuar, që jeton larg Shkodrës dhe Shqipërisë, e bija e një miku të shtrenjtë dhe

6. Po aty, f. 356.

7. Kur’ani, Jusuf: 31.

8. Kur’ani, Jusuf: 33.

*MOS TË KEMI NDROJTJE
ME MARRË FËMIJËT ME
VETE NË XHAMI.
TË EDUKOHEN SE XHAMIA
ËSHTË VENDI I TYRE.
TA DUAN XHAMINË,
TË RRIKEN NË BESIM,
NËPËRMJET MORALIT
DHE CILËSIVE TË BESIMIT.
T’I LUTEMI ALL-LLAHUT
PËR FËMIJËT TANË,
TË RRIKEN ME BESIM
E TË FORCOHEN NË BESIM.*

një besimtari të vjetër shkodran, më shkruan dhe pyet nëse ka ndonjë mundësi që të na dërgojë një shumë prej 400 eurosh për të bërë një kurban, pasi në vendin ku ajo jeton, ligjet e vështirësojnë therrjen e kurbanit sipas traditave islame. Pasi e sqaroj për veprimin që duhet të bëjë, i them se në momentin e parë të marrjes së shumës, do të bëjmë publike edhe emrin tuaj dhe rastin në fjalë. Më thotë: “Mua më intereson të kryhet amaneti im, që jam e bindur se po e lë në duart më të sigurt, ndërsa për emrin, nuk dua të më përmendni, se po e bëj për hatër të Zotit”! E kuptoni? Kjo është dhënia me njerëz dorë, sa mos ta dijë tjetra.

Dëgjova një ditë një person që tregojë me gisht për bamirësi të ndryshme, thoshte: “Meqë njerëzit nuk po na e dinë, inshallah na e di Zoti!”

O zotëri, lëri njerëzit, “Bëje të mirën e hidhe në det, po se pa peshku e sheh Zoti vetë”, siç thotë fjala e urtë popullore!

Në fund, i lutem All-llahut të Madhëruar të na udhëzojë drejt më të mirës, të na falë gabimet e gjynahet dhe të na bëjë prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj! Amin!

(Hytbe e mbajtur
në xhaminë e Parrucës)
Shkodër, më 2 tetor 2015



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

DISA VIRTYTE TË Z. ALIUT

Ka qenë i pari i të rinjve që ka pëlqyer fenë Islame. Ka qenë i pari që ka bërë dyluftim vetëm me shpatë në luftën e Bedrit, mandej filloi lufta e myslimanët dolën fitimtarë.

Është i dashuri i besimtarëve.

Në luftën e Khajberit kundra çifutëve, në vitin e 7-të, kur u munduan myslimanët (pa sukses) për të hyrë në kështjellat e tyre, Profeti (a.s) tha që të pushohej, mbasi të nesërmen do t'i jepte flamurin një njeriu, i cili do të fitonte luftën me shokët e vet.

Kur erdhi e nesërmja, shumë prej sahabëve dëshiruan të fitonin këtë dëshmi, mbasi Profeti (a.s) tha se ai njeri që fiton luftën, atë e do Zoti (xh.sh).

Profeti (a.s) pyeti: Ku është Aliu? Disa thanë: Është i sëmurë, po i dhëmbin sytë. Hz. Aliu erdhi, Profeti (a.s) ia fshiu sytë Aliut me dorën e tij, që u shëndoshën menjëherë, si me ilaçin më të përshtatshëm dhe atëherë i dha flamurin. Mbas pak, u mbytën çifutët dhe ranë kështjellat e kullat e tyre në duar të muslimanëve.

Hz. Aliu ishte njëri prej atyre që morën pjesë edhe në përgatitjen e xhenazës së Resulull-llahut (a.s).

NË KOHËN E EBU BEKRIT (R.A)

Kur u zgjodh kalif Ebu Bekri, Hz. Aliu qe nga të parët që pranoi atë vendim të sahabëve, që dhanë besën e u falën mbas Ebu Bekrit (r.a). **Çka thuhet se ai Zotëri u ndrye në shtëpi disa muaj, derisa shkroi Kur'anin nga mendja, nuk është e vërtetë. Çka thuhet se ai u hidhërua nga Ebu Bekri e nuk u falte mbas tij, është lajm i pavërtetë, në bazë të interpretimeve të dijetarëve të mirë e të saktë.**

HZ. ALIU (R.A) KALIF

Kur vdiq e ndërroi jetë Profeti (a.s), u çua zonja Fatime të kërkojë trashëgiminë e babës së vet.

Ebu Bekri i tha asaj dhe burrit të saj, Hz. Aliut, e të tjerë sahabë, se Profeti (a.s) ka thënë: "Ne Profetët nuk trashëgohejmë, çka kemi lënë mbas nesh, është lëmoshë për nevojtarët". Këtë hadith e pranuan ata e të tjerë sahabë, prandaj zonja Aishe, vajza e Ebu Bekrit, dhe zonja Hafsa, vajza e Hz. Ymerit nuk kërkuar trashëgimi nga burri i tyre, d.m.th. nga Profeti (a.s). Më vonë Hz. Aliu, kur u bë kalif, nuk ndryshoi vendimin e Ebu Bekrit, se ishte vendim me baza, i drejtë.

Thuhet se po të kishte të drejtë Profeti (a.s) për të mbledhur pasuri e për ta trashëguar atë, do të gjendej dikush që do të thonte se ideja, thirrja e misionit të Profetit (a.s) ka qenë me qëllim fitimi në këtë jetë.

Mos kujto, lexues, se Profeti (a.s) ka punuar për këtë jetë e ka pasur pasuri. Prite Zot! Ai ka qenë një shembull i shkëlqyer i drejtësisë, i ndershmërisë dhe i nderimit të mësimëve të pastra të fesë Islame, të urdhrave e detyrave hyjnore.

Në kohë të Ebu Bekrit u armatos z. Aliu për të dalë në luftë kundra murtedëve, por Hz. Ebu Bekri e ktheu, mbasi kishte nevojë për dijen e këshillën e tij.

NË KOHËN E HZ. OMERIT (R.A)

Hz. Aliu ishte një nga këshilltarët më të mirë e më të parë të Hz. Omerit. Hz. Aliu qe ai që propozoi para Hz. Omerit, Kalendarin Islam me fillim të muajit Muharrem, të parin vit të emigrimit dhe kjo ide u pëlqye.

Hz. Omeri një ditë para anëtarëve të këshillit tha: "Në kohën e Profetit (a.s), ai që pinte alkool dënohej me 40 thupra shtatit e disa herë me 80". Pastaj i pyeti ata çka thonë. Ç'duhet të zbatojnë, mbasi disa njerëz po pijnë, po dehen e po dëmtojnë veten e të tjerët?

Hz. Aliu tha: "Ai që pi, dehet, ai që dehet flet pa dije e shpif, ai që shpif për të tjerët, të goditet me 80 thupra". Dhe fjala e tij u pranua.

NË KOHËN E HZ. OSMANIT (R.A)

Hz. Aliu vazhdoi të jetë këshilltar te Hz. Osmani për çështje të ndryshme. Në kohë të Hz. Osmanit u gjet një grua me burrë të huaj. U kapën dhe u sollën tek Osmani. Hz. Aliu ndërhyri e tha se ajo femër nuk di, nuk është e ndërgjegjshme, është pa mend. Ai shtoi se dinte nga Profeti (a.s) se nuk ndëshkohet i vogli deri sa të rritet, i fjeturi deri sa të zgjohet nga gjumi dhe i marri (i çmenduri) deri sa t'i vijë mendtë.

Hz. Osmani e zbatoi kërkesën e Hz. Aliut dhe e liroi gruan.

Kur erdhën 1000 e më tepër vetë në Medinë për të qortuar Hz. Osmanin, të cilët më vonë edhe e vranë, Hz.

Çka thuhet se ai Zotëri u ndrye në shtëpi disa muaj, derisa shkroi Kur'anin nga mendja, nuk është e vërtetë. Çka thuhet se ai u hidhërua nga Ebu Bekri e nuk u falte mbas tij, është lajm i pavërtetë, në bazë të interpretimeve të dijetarëve të mirë e të saktë.

Aliu në atë kohë i shfaqti gatishmëri për të luftuar kundër tyre dhe vuri në dispozicion dy djemtë e tij, Hz. Hasanin e Hz. Hysejnin për ta mbrojtur, por ai nuk pranoi.

HZ. ALIU (R.A) KALIF

Kur u vra Hz. Osmani, në muajin e fundit të vitit të 35-të dhe, jeta u bë e vështirë pa qeverisje, erdhën disa burra të urtë e me fjalë të shumta dhe e nxitën z. Alinë të pranojë të jetë kalif.

Hz. Aliu u tha atyre se me fjalën tuaj nuk pranoj, dua që populli të më pranojë. Të nesërmen erdhën njerëzit

në xhami, ku u betuan se e pëlqejnë si kalif e se do të zbatojnë kërkesat e tij.

DISA PROBLEME TË VËSHTIRA NË KOHËN E TIJ.

1. Kur u mbyt hz. Osmani aq keq, fisi i tij, Muavija me shokë, kërkoi të ndëshkohen kriminelët e ndyrë si e drejtë fetare që kanë për të kërkuar gjakun e të vrarit.

H. Aliu me mendjen e tij të madhe, me logjikën e tij të dalluar u tha: Akuzoni kë të doni që ka bërë atë krim dhe qeveria është gati ta hedhë në gjyq e të zbatojë drejtësinë.

Mirëpo kjo qe e kotë, se në atë ngatërresë kishte hyrë krimineli e ata nuk mundën të akuzojnë me fakte ndonjë njeri të veçantë.

H. Aliu në këtë gjendje s'mund të bënte asgjë, mirëpo kundërshtarët paraqitën akuzën se Aliu ka dëshiruar të vritet hz. Osmani e se ai i njeh kriminelët. Njerëzit e lehtë besuan e kujtuan se hz. Aliu u dobësua, ose pëlqeu së paku vrasjen e hz. Osmanit, gjë që është gënjeshtër pa asnjë fakt.

Më vonë, kur ia lëshoi hz. Hasani qeverinë Muavijes, çka bëri ky i dyti për gjakun e hz. Osmanit? Asgjë, se nuk kishte fakte të sigurta kundra dikuj.

2. H. Aliut, si djali i xhaxhait të Profetit (a.s.), i janë ngjitur disa shpifje merimange për jetën e tij, kanë thënë p.sh. se Profeti e ka lënë zëvendës mbas tij. A ka mundësi që ata sahabë të mëdhenj të refuzojnë kërkesën ose vendimin e Profetit (a.s.) që të jetë hz. Aliu kalif mbas Profetit? Është një gënjeshtër pa asnjë fakt. Ne dimë se vetë hz. Aliu nuk e ka përmendur atë gjë.

U pyet hz. Aliu: - A ju ka lënë ju Profeti (a.s.) ndonjë testament të veçantë?-Jo, tha ai, betohem se nuk na ka lënë gjë të veçantë nga të tjerët.

Kur u shtrua për të vdekur, hz. Aliu nuk pranoi të linte zëvendës djalin e vet, hz. Hasanin, por tha; I lë njerëzit si i la Profeti (a.s.), d.m.th pa caktuar kalif mbas tij.

Pse? Pse Profeti (a.s.) nuk emëroi të afërt të vet të aftë në punë të larta e me pozitë. Shkaku ka qenë i qartë, që njerëzit të mos flisnin keq për fisin e Profetit (a.s.)

Ai nuk ka emëruar xhaxhain e vet, tregtarin e madh, as Hamzan, burrin me famë, as Alinë nuk e emëroi një herë si

të parë të vendit, ose si kryetar ushtrie.

Ata që kujtojnë se sundimi në fenë tonë ka qenë mbretëri e trashëguar, gabojnë. Dihet se as Ebu Bekri, as Omeri, as Osmani, bile as Aliu nuk lanë ndonjë prej fëmijëve të vet kalif mbas tyre. Ata që kujtojnë se profecia ose sundimi janë çiflig që trashëgohet, gabojnë.

Profecia është zgjidhje e Zotit xh.sh. e përgjegjësi e madhe, po ashtu edhe sundimi është përgjegjësi më tepër se fitim.

Ata që thonë se Profeti (a.s.) la hz. Alinë kalif mbas tij, gabojnë, flasin pa fakte të pranueshme të atij që di vleftën e fjalës së thënë ose të shkruar. Ata që thonë se Profeti (a.s.) ka urdhëruar që kalif mbas tij do të jetë hz. Aliu e nuk e shpalli atë gjë, dashur e pa dashur, akuzojnë Profetin (a.s.) se ai nuk ka interpretuar gjithçka ka urdhëruar për të interpretuar, atëherë thuhet që ka munguar në interpretimin e fesë si duhet.

Buhariu transmeton se, kur u sëmur Profeti (a.s.), hz. Abazi i tha hz. Aliut (r.a): Le të shkojmë tek ai e ta pyesim për kë mendon të sundojë mbas tij. Nëse është ndër ne, do ta dimë e, nëse është nga të tjerët, do të kërkojmë që ai zëvendës të interesohet për ne.

H. Aliu tha: Jo, jo. Ne nuk do të pyesim për asnjë rast, unë nuk e shoh të arsyeshme një pyetje të tillë për këtë problem.

3. U zhvilluan disa luftëra të gjata e të egra ndërmjet Muavijes me Aliun, ku u vranë mijëra njerëz, secila palë thonte se është me të drejtën e lufton për të drejtën.

Në fund Muavija i dërgoi hz. Aliut njerëz me propozimin që të ndalojnë luftën, të kthehen në Kur'an, çka gjykon Kur'ani dhe ta zbatojnë të dy palët.

H. Aliu e pranoi këtë propozim që bashkonte vëllezërit e kursente jetë njerëzish. Përfaqësuesit që u zgjodhën nga të dy palët vendosën që të hiqen hz. Aliu dhe Muavija dhe populli të zgjidhte njerëzit që mendonte se janë të aftë.

Kjo shkaktoi përçarje në ushtritë e Aliut e të Muavijes. Ushtria e Muavijes nuk e pranoi atë vendim, kurse shumë nga ushtarët e hz. Alisë e konsideruan Alinë të dalë nga feja, që pranoi atë propozim dhe e luftuan. Këta u quajtën havarixhë, të dalë nga radhët. H. Aliu

H. ALIU ISHTE NJË NGA KËSHILLTARËT MË TË MIRË E MË TË PARË TË HZ. OMERIT. H. ALIU QE AI QË PROPOZOI PARA HZ. OMERIT KALENDARIN ISLAM ME FILLIM TË MUAJIT MUHARREM, TË PARIN VIT TË EMIGRIMIT DHE U PËLQYE.

u detyrua t'i luftojë, derisa i shpartalloi dhe i pakësoi.

Mbas këtyre luftërave me havarixhët, një shok e pyeti hz. Alinë: Çka thua për luftërat me ata që janë qafira (mohues feje)?

Aliu u përgjigj: Jo, prej qyfit kanë ikur.

Ai pyeti përsëri: A janë hipokritë?

Jo, hipokritët (dyfytirëshit) falen pak e nuk përmendin Zotin (xh.sh), kurse këta falen shumë.

Pra, si t'i quajmë?

Vëllezërit kanë dalë kundra nesh pa të drejtë.

Përveç kësaj, disa të tjerë, të ndikuar nga propaganda çifute, thanë se tek Aliu ka hyrë shpirti i Zotit, Aliu është zot.

Aliu i mblodhi të parët e tyre, u kallëzoi se ai është një rob i Zotit (xh.sh), ha, pi, lodhet e fle, bile nuk mund të bëjë çka dëshiron.

Disa vazhduan në atë qyfir, u deklaruan murteda (renegatë), prandaj hapi një hendek, vuri në të zjarr. Ata që ende besuan se ai është Zot, i hodhi në zjarr, ku u dogjën para zjarrit që i pret në jetën e ardhme.

U mërzit hz. Aliu nga ushtria e tij, veçanërisht mbasi u shpërnda, dëshiroi të mos ishte gjallë, të vdiste.



Lavdrim Hamja,
imam, xhamia "Dy Vajzave"

Sa herë që më jepet rasti, apo mundësia të flas për shtypin islam, kam dëshirë të përmend një hadith të Pejgamberit (a.s), të cilit nuk i kushtohet rëndësi dhe nuk i jepet vëmendja e duhur, veçanërisht prej intelektualëve myslimanë.

Hadithin e transmeton Xhabiri (r.a) i cili thotë se, në ditën e betejës së Ahzabit, Pejgamberi (a.s) tha: "Kush është ai që e mbron nderin e myslimanëve?" Keab ibn Malik tha: "Unë". Ibn Revaha tha: "Unë". Ndërsa kur Hasan ibn Thabiti tha: "Unë". Pejgamberi (a.s) i tha: "Po, sulmoji ata dhe do të ndihmojë kundër tyre Xhibrili!"

Që, Hasan in Thabit ta bënte sa më mirë këtë detyrë, Pejgamberi (a.s) ngarkoi Ebu Bekrin (r.a) t'ia mësonte emrat e fiseve arabe, në mënyrë që reagimi ndaj sulmeve, me poezi të idhujtare, të kishte efektin e duhur. Dhe, me të vërtetë ashtu ishte, sepse disa idhujtarë, (të cilët më vonë, kur u çlirua Meka, hynë në Islam), thanë se, atë që na e ka bërë Hasani me gojë, nuk na e keni bërë me shpata!

Edhe Allahu i Madhëruar na tregon në Kur'anin Famëlartë se, detyrë nuk është vetëm kumtimi i mesazhit, por ky kumtim duhet të jetë në formën më të përsosur. Ai (xh.sh), duke na treguar për rolin e të dërguarve të Tij, thotë kështu: "A nuk është detyrë për të Dërguarit, vetëm se kumtimi i qartë"? (Nahl: 35)

E vërteta është se, realiteti i medias islame tek ne, të lë shumë për të dëshiruar. Ai është i dobët, i brishtë dhe nuk e jep efektin e duhur tek masat. Kjo për mendimin tim, është rezultat i mentalitetit të myslimanëve në përgjithësi, të cilët nuk e quajnë

NË PROMOVIM TË NUMRIT 150 TË GAZETËS "UDHA ISLAME"

shpenzim në rrugën e Zotit, kontributin e tyre në fushën e medias. Atëherë, si mund të forcohet roli dhe efekti i medias islame, ndërkohë që xhamia islam më shumë jep për një tapet xhamie, orë muri, apo raft këpucësh, sesa kur i kërkohet të kontribuojë për botimin e një libri, shtypjen e një gazete, publikimin e një websiti, realizimin e një emisioni në radio, apo televizion etj?!

Unë besoj se, derisa myslimanët ta vendosin në plan të parë rolin e medias në përhapjen e mesazhit islam, duke i kushtuar rëndësinë e duhur, jo vetëm përmbajtjes, por edhe formës së prezantimit të saj, nuk do të arrijmë, si duhet të kryejmë detyrën e përhapjes dhe përcjelljes së mesazhit të fesë, dhe as të marrim frytet e duhura në mësimin dhe edukimin e njerëzve me parimet dhe mesazhet e Islamit.

Nëse i hedhim një sy shtypit islam pas viteve '90 dhe deri në ditët e sotme, do të vëmë re se ai është akoma në fazën e tij fillestare dhe nuk ka fuqinë dhe forcën e duhur për të konkuruar qoftë shtypin laik, por edhe atë fetar. Si mundet shtypi islam i këtyre viteve, me gazeta dhe revista një-mujore, apo tre-mujore t'i bëjë ballë gjithë atyre sulmeve mediatike, por veçanërisht gazetave ditore, të cilat kanë një tirazh shumë herë më të madh dhe hapësirë shpërndarjeje shumë të gjerë, sesa gazetat dhe revistat tona?!

Kështu që, pa ndryshuar mentalitetin dhe përqasje ndaj mbështetjes për shtypin islam, ne nuk do të ecim përpara në këtë fushë dhe as nuk do të jemi të zotë të mbrojmë "nderin" e myslimanëve, ashtu siç kanë thënë Pejgamberi (a.s) në hadithin e cituar në fillim të këtij shkrimi.

Gazeta "Udha Islame" është e re në moshë, ajo ka 13 vite jetë, por me gjithë luhatjet e saj, ka mbetur dinjitoze në fushën e vet.

Duke parë natyrën e saj, si gazetë zyrtare e institucionit të Myftinisë Shkodër, është e imponuar t'i qëndrojë besnik disa përkufizimeve në përmbajtje. Në lidhje me këtë çështje them se, duke ditur vlerën që kanë për të ardhmen e Islamit

dhe myslimanëve në këtë vend, regjistrimi i ngjarjeve të ndryshme, aktiviteteve dhe veprimtarive fetare, kulturore, shkencore etj, vendi i tyre në gazetë është në sasinë duhur dhe jo i tepërt. Sepse, brezat e ardhshëm, kanë të drejtë të gjejnë të pasqyruara aktivitetet e myslimanëve të sotëm, si një frymë besimi, që trashëgohet ndër breza, duke ruajtur gjurmën dhe cilësinë e përkushtimit.

Rëndësia tjetër, e këtyre kronikave qëndron edhe në faktin se në të ardhmen do të shërbejnë si burimi dhe referenca për studime të ndryshme. Shumë fakte rreth Islamit dhe myslimanëve në Shqipëri janë zhdukur dhe po zhduken nga mungesa e evidentimit dhe regjistrimit të tyre, përmes shtypit në përgjithësi, por atij islam në veçanti.

Në përfundim, duke theksuar edhe një herë domosdoshmërinë e rritjes së rolit të shtypit islam, i cili ka për qëllim edukimin e njerëzve me parimet e moralit të lartë islam, ushqimin e tyre me vlera të dobishme për jetën e kësaj bote, por edhe asaj të përtejmes etj, po e mbyll me disa thënie të mendimtarit dhe filozofit të thellë islam, dr. Mustafa Mahmud, i cili në disa libra të tij thotë:

"Kur do të kthehet ajo, epërsia intelektuale dhe rizgjimi mendor, për fenë, mrekullia e parë e së cilës ishte intelektualizmi?! Allahu nuk i dha të Dërguarit të Tij, Muhammedit (a.s) shkop për të çarë detin, por i dha argument, qartësi dhe logjikë që mahnisin mendjet". (Dr. Mustafa Mahmud, nga libri "Alemul-esrar")

"Gjëja më e keqe, të hapësh sytë në mëngjes me gazeta përpara, që do të thotë se ti i ke hapur luftë nervave tuaja çdo ditë. Çdo mëngjes duke pirë stresin, frikën, tmerrin, rrezet atomike dhe bombat bërthamore, kërcënimet e ftohta dhe ato të nxehta. E nëse gruaja të thotë "mirëmëngjes", gazetat të thonë keq mëngjesi", "mëngjesi i dështimit", "mëngjesi i copëtimit" dhe "mëngjesi i shkatërrimit". (Dr. Mustafa Mahmud, nga libri "Min jevmijat nas el-lejl")

7 tetor 2015



Ervil Kuçi
imam, xhamia Dërgut

Në historinë tonë islame ka shumë ngjarje të cilat edhe pse kanë ndodhur prej shekujsh na përcjellin mesazhe dhe mësimë në ditët e sotme që mund të na vlejné në jetën tonë të përditshme, sepse historia përsëritet edhe pse vendi dhe largësia kohore mund të ndryshojné.

Një nga këto ngjarje me rëndësi është edhe dita e Ashures, e cila për shumë njerëz nënkupton një ditë kremtimi dhe feste ku shpërndahen ëmbëlsira, gjë e cila e humb edhe thelbin e mesazhit të kësaj dite të veçantë.

A është dita e Ashures një ditë feste dhe ëmbëlsirash apo një ditë adhurimi ku Zoti shpërblet besimtarët me sevape dhe shlyerje gjynahesh?

Më së miri na e shpjegon hadithi i Pejgamberit (a.s) të cilin e transmeton Abdullah ibn Abasi, kur Pejgamberi (a.s) erdhi në Medinë vuri re hebrenjtë, që agjëronin ditën

DITA E ASHURES DHE MESAZHI I SAJ

Secili prej nesh ka pasur një ditë të vështirë në jetën e tij, një ditë që ndoshta jeta e tij ka qenë në fije të perit, ose puna e tij, ose është sprovuar shumë herë dhe me ndihmën e Allahut e ka kaluar.

e Ashures dhe i pyeti për shkakun, e ata iu përgjigjën: “Kjo është një ditë e madhe. Atë ditë Allahu e shpëtoi Musain dhe popullin e tij nga dhuna e Faraonit. Si falënderim për këtë, profeti Musa agjëroi atë ditë. Edhe ne për respekt agjërojmë”. Pejgamberi (a.s) u shpreh: “Ne e nderojmë më shumë se ju profetin Musa”.

Duke mbajtur edhe vetë agjërim, urdhëroi popullin e tij të agjërojë ditën e Ashures. (Muslim, Sijam, 128).

Pasi u bë obligim agjërimi i Ramazanit atëherë Pejgamberi (a.s) solli një lehtësim mbi agjërimin e kësaj dite duke thënë: “Pa dyshim që dita e Ashures është një ditë nga ditët e Allahut. Kush të dojë agjëron dhe kush te dojë, jo.” (Buhari, Sijam, 57; Muslim, Sijam 117).

Ndërsa Ebu Katade transmeton se sahabët e kanë pyetur Profetin (a.s) për agjërimin e ditës së Ashures dhe ai u ka thënë: “Agjërimi i ditës së Ashures i shlyen gjynahet e vitit të kaluar.” (Muslim, Sijam, 196).

Dita e Ashures na përcjell mesazhin, që ashtu siç u sprovuan Pejgamberët e Allahut (xh.sh), ashtu do të sprovohemi edhe ne. Ashtu siç kishin nevojë ata për mbështetjen në Zotin e gjithësisë dhe për ndihmën e Tij, kemi nevojë edhe ne çdo ditë të jetës tonë.

Secili prej nesh ka pasur një ditë të vështirë në jetën e tij, një ditë që ndoshta jeta e tij ka qenë në fije të perit, ose puna e tij, ose është sprovuar shumë herë dhe me ndihmën e Allahut e ka kaluar. Kështu që kjo ditë nënkupton të gjitha ato ditë, kur ne kemi pasur nevojë për Allahun dhe e kemi gjetur gjithmonë prezent në momentet më të vështira të jetës sonë. Prandaj kjo ditë na kujton sesi të jemi falënderues me agjërim (në rastin konkret), e cili adhurim shpërblehet më së miri sesa agjërimi për të cilin Allahu (xh.sh) thotë në hadithin kudsî : “Çdo vepër e birit të Ademit është e tij, përveç agjërimit, ai është i Imi dhe Unë shpërblej për të.”

Është për t'u habitur, kur sheh njerëz të cilët në vend që ta shfrytëzojnë shpërblimin e kësaj dite në adhurim, e shfrytëzojnë për kremtime dhe qerasje, ndërkohë që kjo ditë është shumë e rëndësishme për ne pasuesit e Pejgamberit (a.s), për nga mesazhet dhe mësimet që na jep.

Lutem në Allahun (xh.sh), që të jemi falënderues dhe mirënjohës ndaj begatave të Tij të pafundme, dhe për këto ditë adhurimi të na shpërblejë më të mirën e mundshme. Amin!

**“AGJËRIMI
I DITËS SË ASHURES I SHLYEN
GJYNAHET E VITIT TË KALUAR.”**

“MBRO MJEDISIN!” AKTIVITET ME NXËNËSIT E XHAMISË KULLAJ

Në ditën e tretë të Kurban Bajramit, pikërisht më, 26 shtator 2015, nxënësit e mejtepit të xhamisë Kullaj, me iniciativën e tyre dhe në koordinim me sektorin e arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizuan një aktivitet sensibilizues dhe promocional për pastrimin e ambienteve të ndryshme të fshatit Kullaj.

Motoja e nxënësve në këtë aktivitet social ishte: “Mburo mjedisin”, sepse siç u shprehën edhe ata: “Mjedisi mund



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

***“Në rrugë ishte një degë,
e cila i pengonte njerëzit.
Një njeri e largoi atë nga
rruga dhe hyri në xhenet”***

(Transmeton Imam Ahmed)

të jetojë pa ne, por ne nuk mund të jetojmë pa mjedisin e pastër”. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte për të kryer një detyrë ndaj mjedisit që është padyshim një vlerë e paçmueshme për krejt komunitetin. Njëkohësisht, me synimin për të sensibilizuar dhe inkurajuar të gjithë qytetarët që të mbrohet pasuria natyrore, duke dhënë shembullin për një reagim në kohë reale ndaj çdo akti në dëm të

mjedisit dhe ndotjes së tij në mënyrë të papërgjegjshme.

Imami dhe mësuesi i nxënësve të mejtepit, të xhamisë Kullaj, z. Aldin Selhani tha se edhe në të ardhmen do të organizohen aktivitete të kësaj natyre, duke përfshirë dhe ftuar edhe xhamitë e tjera të zonës së Postribës që të ndërmarrin kësaj iniciativash në dobi të individit dhe të shoqërisë.

MYFTIU INSPEKTOI PUNIMET PËR XHAMINË E FSHATIT KULLAJ

Ditën e xhuma, më 2 tetor 2015, pas faljes së xhumasë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka zhvilluar një inspektim për të parë nga afër punimet që po kryhen

për xhaminë e re në fshatin Kullaj.

Myftiu u shpreh se punimet për këtë xhami të re, kanë tejkaluar shumë pritshmëri, pasi ajo po kthehet në një kala besimi dhe një objekt të mrekullueshëm, që do të tregohet me gisht, në mesin e xhamive të shumta të Shkodrës.

Gjatë këtij inspektimi u panë nga afër punimet në brendësi të objektit, ku spikat hapësira e bollshme e objektit, dritaret e shumta, forma interesante e mihrabit dhe minberi i përfshirë në një prej cepave të saj, si dhe anekset plotësuese të tij, që do të shërbejnë për mësimin e fëmijëve të këtij fshati.

Në këtë vizitë, Myftiu shoqërohej edhe nga pjesëtarët e stafit të tij, z. Lavdrim Hamja, z. Ervil Kuçi, z. Besmir Selmani si dhe nga z. Altin Shabaj, administratori i ri i komunës Postribë.

Xhamia e fshatit Kullaj po ndërtohet

në vakëfin e saj të Shenjtë, edhe falë koordinimit të Myftinisë Shkodër me Fondacionin "Mirësia", si dhe kontributet e çmuara vullnetare të krejt besimtrëve vendas.



HAXH TË PRANUAR, TË DASHUR HAXHILERË TË SHKODRËS!

Në orët e para të mëngjesit të së shtunës, më 3 tetor 2015, ka mbërritur edhe grupi i dytë i haxhilerëve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në mesin e të cilëve edhe haxhilerët e Shkodrës.

Në pritje të tyre, në aeroportin e Rinasit, kishte dalë edhe Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u takua me të gjithë haxhilerët, ku u interesua për shëndetin dhe udhëtimin e tyre, si dhe uroi haxh të pranuar dhe adhurime të shumëfishuara.

Myftiu u lut që kjo eksperiencë besimi të ketë shërbyer për secilin, si një besëlidhje e re me Zotin dhe një hap cilësor në jetë, në rrugëtimet e reja të besimit dhe kërkimit të pëlqimit të Zotit në jetën e përditshme.

Myftiu uroi edhe imamët e pranishëm në këtë udhëtim jete, që ishin mbushur me emocione të mëdha dhe shprehnin falënderime ndaj Zotit për këtë mirësi



të madhe dhe mundësinë e realizimit të këtij adhurimi të mrekullueshëm.

Pak momente para ezanit të sabahut, haxhilerët e Shkodrës mbërritën para xhamisë së Parrucës, në pritje të cilëve kishin dalë familjarë e dashamirë, të përmalluar e plot gëzim për kthimin e

tyre shëndosh e mirë, pranë familjeve e miqve.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër uron Haxh të pranuar për krejt haxhilerët e Shqipërisë, veçanërisht atyre të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.


16 NËNTORI PO AFRON, KËRKOJMË LUTJET DHE MBËSHTETJEN TUAJ!

Në kuadër të përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, që sinjalizoi edhe rilejimin me ligj të praktikës dhe lirisë fetare në vendin tonë, Myftinia Shkodër, vazhdon përgatitjet për ta kthyer këtë datë në një festë të rëndësishme dhe ditë të shënuar, mbi krejt datat dhe ditët.

Paraditen e sotme, më 5 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B.

Sytari, ishte në terren, për të ndjekur dhe orientuar përgatitjet për këtë ngjarje të shënuar, më e rëndësishmja për muslimanët e Shqipërisë, në 25 vjetorin e ceremonisë madhështore, që mbledhi dhjetëra mijëra muslimanë shkodranë, në një ditë dëshmie.

Vlen të përmendet se viti 2015, është shpallur nga Myftinia Shkodër, si vit jubilar, sikurse është dhënë udhëzim për krejt imamët dhe xhamitë



e Shkodrës, që të jenë në lartësinë e kësaj ngjarje dhe reflektimin e saj në aktivitetet e shumta, që janë zhvilluar këtë vit dhe ato që do pasojnë.

Myftinia Shkodër, fton të gjithë qytetarët e saj që të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë ndihmën dhe përkrahjen e tyre, në shërbim të përkujtimit sa më madhështor të kësaj ngjarjeje dhe përhapjen me urtësi të vlerave islame në Shkodër dhe përtej saj.



AKTIVITETE T NË NJË MUAJ



Ë LARMISHME J VLERASH...




BASHKËBISEDIM MBI LIBRIN: “NÚN PASHA LAPSIN...”

Ditën e mërkurë, më 7 tetor 2015, Radio 1, zhvilloi një bashkëbisedim me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, duke u përqendruar te libri i tij: “Nún Pasha Lapsin...”.

Myftiu iu përgjigj pyetjeve mbi detajet e këtij libri, që përmban shënimet vetjake të Myftiut të Shkodrës, në periudhën prill 2010-prill 2013.

Gjatë këtij bashkëbisedimi me gazetarin Qani Sulku, Myftiu vuri në dukje rëndësinë që ka shkrimi dhe regjistrimi i historisë së sotme islame, me krejt detajet dhe ngjarjet e saj, si një dëshmi edhe për të ardhmen. “Unë mendoj se krejt imamët dhe myftilerët duhet të angazhohen për ta shkruar sa më bukur historinë e sotme islame, atë që e jetojmë, atë, ku shërbejmë, personazhet e saj, detajet, datat, vendet, ndërtimet, aktivitetet, konferencat, tubimet, mesazhet etj”, - theksoi Myftiu.



Pyetjes së gazetarit mbi rëndësinë dhe kujtimet e datës 16 nëntor 1990, Myftiu iu përgjigj se kjo datë është ditë dëshmie e besimit dhe mosthyerjes së tij para asnjë persekutimi e dhune kundër Islamit dhe muslimanëve. Ai tha se ajo ditë ishte dëshmi e madhe se populli ynë nuk e ka humbur dritën e besimit as udhëzimin nga Zoti. Njëkohësisht, theksoi se kjo datë duhet skalitur në muret e historisë

tonë kombëtare si më e rëndësishmja që pasoi fatkeqësinë më të madhe kombëtare, sundimin për 23 vjet të ateistëve-komunistë.

Këto dhe shumë pyetje të tjera drejtuar Myftiut të Shkodrës, si dhe parathënien e librit nga studiuesi Muhidin Ahmeti, u transmetuan ditën e enjte, më 8 tetor 2015, ora: 10.10, në valët e Radio 1.

LOZANË, MYFTIU MORI PJESË NË AKTIVITETET E QENDRËS ISLAME SHQIPTARE

Me ftesë të Qendrës Islame Shqiptare të Lozanës (Zvicër) dhe kryetarit të saj, z. Fehim Abazi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga kjo qendër islame, në datat 9-10 tetor 2015.

Ditën e xhuma, më 9 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, mbajti dersin e para xhumasë dhe hytben e saj, ku dha këshillat e tij rreth angazhimit të vazhdueshëm të muslimanëve për ta jetuar fenë e tyre me dinjitet dhe krenari legjitime, sidomos në Zvicër, ku liria fetare respektohet dhe muslimanët shqiptarë e kanë mundësinë më të mirë për ta dëshmuar fenë e tyre, për t'u bërë secili thirrës i urtë dhe i pjekur drejt vlerave islame.

Myftiu mori pjesë edhe në tribunën familjare, që u organizua të shtunën, më 10 tetor 2015, ku mbajti një ligjëratë, duke u përqendruar te domosdoshmëria e ruajtjes së besimit dhe qëndrueshmëri në rrugën e të parëve.



Myftiu tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve të shumtë në këtë tubim, drejt rëndësisë që ka ruajtja e fesë islame dhe e gjuhës shqipe, edhe për brezin e ri shqiptar në Zvicër, që falë Zotit, po edukohet më së miri me ruajtjen e identitetit fetar dhe atij kombëtar, duke e dëshmuar këtë gjë me shembuj të mrekullueshëm, që duhen vlerësuar.

Ai vlerësoi kontributin e madh të shqiptarëve në Zvicër për të ndërtuar xhami të reja, të cilat sa vijnë e shtohen, duke dëshmuar njëkohësisht se ato janë vatrat më të mira dhe më serioze, ku shqiptarët gjejnë veten, gjurmët e pastra shekullore, traditat, gjuhën, kulturat dhe bashkëpunimin në mes vete.

U PROMOVUA NR. 150 I GAZETËS “UDHA ISLAME”



Në kuadër të aktiviteteve të larmishme, në prag të përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, pas persekutimit komunist, pasditën e së mërkurës, më 7 tetor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një takim promovues të nr. 150 të gazetës “Udha Islame”, në të cilin morën pjesë një grup i ngushtë me imamë, intelektualë, drejtues të shoqatave islame etj.

Aktiviteti u përshëndet nga kryeredaktori i parë i kësaj gazete, teologu Arben Halluni, që foli mbi vlerën e madhe që ka gjallërimi dhe lulëzimi i shtypit islam, sidomos në Shkodër. Ai tha se dalja në dritë e numrit të parë të gazetës “Udha Islame”, ishte një gëzim i madh për Myftininë Shkodër dhe dashamirët e saj. Njëkohësisht uroi suksese dhe vlerësoi arritjet e deritanishme të saj.

Fjala e tij u pasua nga analiza e kryeredaktorit aktual të gazetës “Udha Islame, teologut Lavdrim Hamja, që hodhi dritë mbi rëndësinë që ka fuqizimi i muslimanëve në informacion. Duke iu referuar thënieve të mendimtarëve të shquar muslimanë të kohës, ai tha se muslimanët e sotëm janë të përgjumur dhe se detyra e tyre është të zgjohen sa më parë, duke kontribuar e poseduar mediat, prej së cilave të përhapet Fjala e duhur, me urtësi e pjekuri, në shërbim të mesazheve hyjnore, që ndërtojnë jetë.


Ndërkohë, teologu Imdir Plaku, foli mbi vlerën e angazhimit të intelektualëve muslimanë dhe teologëve në shërbim të shtypit islam, duke u ndalur te shembulli i gazetës “Udha Islame” dhe ai i Shkodrës.

Imami i nderuar tha se gazeta “Udha Islame”, tashmë në vitin e saj të 13-të, vazhdon të përhapë me sukses mesazhe të urta, që burojnë edhe nga dija dhe studimet e thelluara të dijetarëve më elitare të botës islame, të përkthyer enkas për faqet e kësaj gazete.

Edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi të gjithë ata që kontribuuan për daljen në dritë të kësaj gazete, duke përmendur të gjithë myftilerët e Shkodrës, si drejtues të saj, si dhe kryeredaktorët e saj, për punën e palodhshme dhe angazhimin e lavdëruar.

Myftiu theksoi se gazeta “Udha Islame”, ka nevojë që të vazhdojë në rrugën e saj, për të sjellë para lexuesve të saj urtësinë islame dhe dritën e mesazheve, që përhapen kudo ku ajo mbërrin, jo vetëm në Shkodër e Shqipëri, por edhe përtej kufijve.

Aktivitetin e përshëndeti edhe H. Fejzi Zaganjori, si një ndër redaktorët dhe bashkëpunëtorët më të vjetër të kësaj gazete. Ai shprehu gëzimin e tij për mbërritjen e kësaj dite dhe vlerësoi mundin dhe sakrificën e të gjithë atyre që u angazhuan për këtë mirësi.



Historia do ta shkruajë se, Islami nuk ka hyrë në Evropë në betejën e tij të dytë me shpatë e topa, por me histori të mirë dhe libër. Historia e mirë, është e një burri luftëtar dhe të kolos prej kolosëve të dritës, emri i tij është Alija Izetbegoviq dhe libri, është libri i tij “Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit”.

Burrë, që qëndroi me shokët e tij të ndalë Evropën me luftën e saj të urrejtjes, shigjetat e shpirtligësisë të helmua dhe fushatat e prapambetjes, të cilat i ndërmori kryqtarizmi i çmendur. Tre vite duke luftuar i vetëm, që të mbesë fjala “La ilahe il'lallah” dhe flamuri i dashurisë, mëshirës, drejtësisë dhe lirisë. Ai është flamuri i Evropës dhe jo flamuri i injorancës dhe motivi i luanëve të pyllit.

Ndërkohë, që Islami por rilindte në Evropë, ai furej në atdheun e tij në gjendje ekstremizmi, trazirash dhe luftërash agjenturash të huaja. Në rrjeta merimangash dhe paqeje të dyshimtë, të prodhuar nga Amerika e Izraeli, për të hyrë mbarë rajoni në kthetrat e natës së gjatë.

Do ta shkruajë historia se kjo natë e gjatë, u përshkua nga agimi, pas gjithë kësaj, dhe se fjala “La ilahe il'lallah” mbijetoi, me gjithë intrigat e intriguesve.

“Allahu është triumfues i çështjes së Tij, por pjesa më e madhe e njerëzve nuk e dinë”

Kështu e ka shkruar Allahu që në ezel (fillim).

“Do të triumfoj Unë dhe të dërguarit e Mi”.

“Dhe, se ushtria jonë, ata janë triumfatorë”.

E, historia nuk posedon tjetër, veçse të dëgjojë dhe të bindet, sepse universi nuk ka pronar tjetër, përveç Allahut, Zotit të botëve.

Dr. Mustafa Mahmud,
nga libri “Ala hafeti el-intihar”

U PËRKUJTUA 1437 VJETORI I HIXHRETIT TË HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

Pasdreken e së mërkurës, më 14 tetor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet fetar, në përkujtim të fillimit të vitit të ri hixhri, 1437.

Aktiviteti, që u zhvillua në xhaminë e Medresesë, nisi me fjalën e teologut Arben Halluni, i cili tha se përkujtimi i kësaj ngjarjeje, ka një rëndësi të madhe në jetën e muslimanëve, pasi ajo konsiderohet si një cak shumë i rëndësishëm i zhvillimit të Thirrjes Islame, pas viteve të gjata të persekutimit.

Edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën e rastit, tha se përkujtimi i Hixhretit, është një moment reflektimi në jetën e muslimanëve, për t'u zgjuar nga hutimi dhe për të kuptuar se uniteti dhe forca e tyre në bashkëpunim, po bëhet përherë e më shumë një thirrje që vjen nga shekujt e shkuar dhe realitetet e zymta, plot padrejtësi, persekutim, anashkalim dhe shkelje e të drejtave të muslimanëve në mbarë botën.

Myftiu përmendi vendet islame, të pushtuara nga terrori, dhuna dhe agresioni, si: Siria, Iraku, Palestina etj dhe tha se këto realitete po na imponojnë përherë e më shumë nevojën e madhe të lidhjes dhe afrimit tonë me



thelbin e fesë dhe mesazhet e saj.

Myftiu tha, se Hixhreti na mësoi se ku ka Islam, ka paqe, stabilitet, mirëqenie, harmoni, respektim i të drejtave njerëzore, humanizëm, pastërti e lidhje të sinqertë me Zotin, që garanton krejt mirëqenien në shoqëri.

Aktiviteti vazhdoi me ligjëratat e teologëve, Ervil Kuçi dhe Adil Cukali, të cilët hodhën dritë mbi mësimet që duhen fituar nga leximi i ngjarjes së Hixhretit, duke theksuar se koncepti i tij është më i gjerë se një emigrim material nga një vend në një tjetër, si ai i Hz. Muhammedit (a.s) dhe sahabëve, nga

Meka në Medine.

Në fund, drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, shprehu kënaqësinë e tij për zhvillimin e këtij aktiviteti në xhaminë e medresesë, duke theksuar se nga viti në vit, Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", po afirmohet me rezultatet dhe arritjet e saj të larta, me kushtet dhe stafin e përzgjedhur.

Në përfundim, të pranishmit u përshëndetën me njëri-tjetrin, duke uruar një vit të mbarë hixhri për Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë ymetin islam.

MYFTIU PRITI NËN/KRYETARIN E SHOQATËS "ARDHMËRIA"

Pasditën e së mërkurës, më 14 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, z. Sabaudin Jashari, nën/kryetar i shoqatës "Ardhmëria", Tiranë.

Gjatë takimit, u fol rreth domosdoshmërisë së bashkëpunimit të muslimanëve në mes tyre, si dhe harmonisë në hapjen karshi botës, në rrugën e dëshimit të vlerave islame që burojnë nga Kur'ani dhe Tradita profetike.

Myftiu konfirmoi vullnetin e madh të Myftinisë Shkodër për bashkëpunim dhe mirëkuptim në mesin e muslimanëve, sidomos, në ruajtjen e harmonisë islame në vend dhe ndarjen nga mentalitetet e izolimit, përjashtimit të tjetrit etj.

Gjatë takimit u diskutua edhe mbi rëndësinë që ka shfrytëzimi i kohës dhe i



rinisë në shërbimet ndaj Thirrjes Islame. Në takim merrnin pjesë edhe drejtues

lokalë të shoqatës "Ardhmëria", si dhe antarë të këshillit të Myftinisë Shkodër.



Zenepe Dibra
President e shoqatës
"Gruaja Intelektuale Shkodrane"

Qabja, vendi i shenjte i adhurimit të Zotit, ku çdo vit nga katër anët e botës, miliona njerëz i drejtohen Shtëpisë së Allahut në një hapësirë të bekuar kohe dhe çojnë në vend detyrën e tyre për t'u pastruar nga mëkatet, ka qenë për mua një ëndërr fëmijërie. Axha i jem, një njeri i dashur shumë për mua, me zemër të madhe dhe besimtar i devotshëm, më kishte premtuar se një ditë do të më dërgonte në Qabe, atje larg në një vend të shenjtë, ku do të luteshim që Zoti të na sjellte të mira. Atëherë isha e vogël nuk e kuptoja aq mirë rëndësinë e shkuarjes, nuk dija asgjë për të, vetëm atë që axha më tregonte duke mbetur një dëshirë, më e madhe e axhës se e imja, e cila fatkeqësisht nuk u realizua kurrë. Ah, sikur ta dinte ai që mbesa e vogël atëherë, tashti një ditë do të shkonte pikërisht në atë vend, ku ai më kishte folur aq shumë, por tani me një koshiençë fetare më të plotësuar, më të përmbushur, e kthyer në një devocion të ndriçuar nga mosnjohja, e pastruar nga mohimi i injektuar në shkollat marksiste, për të kërkuar (para së gjithash) faljen e madhe ndaj mëkatit, që pa dashjen tonë na u injektua për shumë vite.

Të nisur nga Xhamia Parrucës, më 15 shtator të 2015, me grupin e shkodranëve për t'u bashkuar më vonë edhe me shqiptarët e tjerë nga i gjithë vendi (bile edhe nga Mali Zi), numri i të cilëve ishte afro 400 vete, në një ceremoni festive të përcjellur nga personalitete fetare të Shkodrës me në krye kryemyftiun Imam Muhamed Sytari, emocioni do të na shoqëronte në çdo moment të udhëtimit.

Një ndjenjë e thellë që na përshkoi ne grave ishte edhe pjesëmarrja e një numri grash nga Bashkia e Shkodrës.

Shumë prej tyre që na përcollën me

KUR NJE EMOCION MUND TE KTHEHET NE DEVOCION

(Pershtypje nga pelegrinazhi i Haxhit
në Meke dhe Medine të Arabisë Saudite, 15 shtator - 2 tetor 2015)

një ndjenjë gëzimi, por edhe përmallimi që ato nuk kishin mundësi ta bënin këtë pelegrinazh të madhnueshëm, duke na përqaftuar na thonin: "Shqyqyr që Zoti ju ka afuar këtë risk por lutuni edhe për ne. Lutuni për gjithë gratë muslimane të Shkodrës!"

Shkodranët besimtarë të devotshëm, kanë ndjekur pelegrinazhin në Meke, shumë vite përpara, në kushte shumë të vështira, që vetëm një devocion i madh ndaj Zotit, do t'i bënte të përballonin kushte shumë më të rënda se ato të sotmet. Shumë prej tyre ranë edhe shehidë të fesë islame në përmbushje të këtij detyrimi, duke u prehur në Tokën e Shenjtë të Mekës.


E paharruar ka mbetur ngjarja e shkuarjes në Qabe më 23 nëntor të vitit 1734, e një grupi shkodranësh prej 8 burrash, kryesuar nga Hasan Kopliku (Xhabija), të cilët të nxitur nga ndjenja të thella fetare, marrin një iniciativë të guximshme për të shkuar në Qaben e Shenjtë, me kuaj dhe arrijnë atje mbas 75 ditësh udhëtimi.

Emocioni i parë për mua erdhi në aeroportin e Rinasit, kur unë fala namazin e akshamit në hollin e pritjes së aeroportit, së bashku me gjithë shqiptarët, bile edhe ato të ardhur nga Ulqini dhe Tivari, pa marrë parasysh asgjë. Shtruar për sexhde çfarë kishim për t'ju lutur Zotit në këtë namaz që t'na printe mbarë udhëtimin për të kryer detyrimin për në Haxh, një nga 5 detyrimet e muslimanit. Ishte namazi i parë për mua, kur ula kokën në sexhde për t'ju falur Zotit për këtë mision që do kryeja. Falja e namazit, lidhja me tokën, ku ne kemi dalë dhe ku do prehem, është një lidhje që rrallë haset në besimet tjera, është një lidhje shpirtërore ku fillon komunikimi, adhurimi dhe ndjenja përulësie para Zotit.

Pas mbërritjes në aeroportin e Xhudahit (ku mbërrinin në çdo orë me mijëra muslimanë nga e gjithë bota), dhe procedurave të ndjekura nga autoritetet arabe për t'u futur në Arabinë Saudite, udhëtimi me autobus do të na dërgonte në qytetin e Shenjtë të Mekës, aty ku kishte lindur Muhammedi (a.s), i Dërguari Allahut, i cili do të ndriçonte botën me fenë islame. Pas

dy ditësh do të shkonim në mënyrë të organizuar për të bërë Umrenë në Qaben e Madhnueshme, natyrisht me avdes të marrur.

Kur mbërritëm atje, pasi zbritëm nga autobuzi, drejtuar nga organizatori, i cili na printe deri në hyrje të xhamisë me flamurin shqiptar, ecem drejt Xhamisë Mesxhidu'l-Haram. Pamja që na u shfaq para syve ishte imponante, madhështore që të impononte një ndjenjë respekti



dhe ngazëllimi që nuk e kisha hasur në udhëtimet në vendet e tjera. Xhamia e Mesxhidu'l-Haram mbas Qabes, ku njerëzit brenda saj janë të gjithë të barabartë, muslimanë të botës, për të mos u dalluar nga kombësia, mosha, pasuria, do të na ftonte brenda për të vazhduar pastaj tavafin që përfaqësonte rrotullimin 7 herë rreth Qabesë.

E kisha parë Qaben në internet, televizor, foto, por kurrë nuk do të më sillte atë emocion që më shkaktoi kur isha tamam përballë saj. Më dukej se isha krejt e dobët para asaj madhështie, por nga ana tjetër më dukej se tashti isha më afër se kurrë me Zotin e Plotfuqishëm dhe në lidhjen me Të ku do filloja komunikimin për t'u lutur për faljen e mëshirën e Tij ndaj gabimeve tona, për dobitë që mund të na sillte. Jo vetëm unë, por kam parë me qindra njerëz që luteshin e qanin duke përsëritur thirrjen me zjarr dhe afsh, kur vinin përballë Gurit të Zi: "Bismilahi

Rrahmani Rrahim, “Allahu Ekber!”

Pa e kuptur fillova të qaja. Çfarë ndjenje qe kjo? As unë nuk e dija. U luta për njerëzit e mi, familjen, të afërmit, miqtë, shoqet, që Zoti t’u sillte shëndet dhe bereqet, t’u zgjidhte problemet, t’u lehtësonte vuajtjet fizike dhe shpirtërore. U luta për nanën time Fatime, një besimtare e jashtëzakonshme, e cila kishte lindur për t’iu shërbyer njerëzve, që më edukoi me ndjenjat fetare, që Zoti t’i falte Xhenetin. Ajo nuk e pat këtë fat të bardhë që të vinte në Qabe dhe unë isha mjaft e lumtur që në këtë Shtëpi të Madhe të Zotit do lutesha për te. U luta për baben, për axhen tim që ishte i pari që më foli për Qaben, u luta për vëllaun dhe shumë njerëz të fisit tim dhe bashkëshortit, që kishin vdekur, që Zoti t’i falte dhe t’u jepte Xhenetin.

Natyrisht që lutja për familjen time, bashkëshortin dhe fëmijët zuri vendin kryesor të lutjeve. Një lutje të përsëritur dhe shumë të përmallshme kam bërë për vendin tim Shqipërinë dhe shqiptarët, por veçanarisht për Shkodrën dhe shkodranët e mij. “O Zot, begatoje Shkodrën e cila ka vuajtur nga pushtuesit e huaj dhe qeverisjet e këqija të njerëzve të saj, ka vuajtur nga tërmetet, përmytjet etj. O Zot, drejtoji shkodranët që të ecin në rrugën e drejtë, pa vrasje e krime, korrupsione, e gjakmarrje! Ban, o Zot, që Shkodra të jetojë gjatë”!

Pas tavafit të Umresë bëme ritin e Sa’jit, një ecje dhe pjesërisht vrapim, 7 herë, vajtje-ardhje midis dy kodrave, të Safasë dhe Mervesë, në distancën prej 350 metrash, në kujtim të rrugës që kishte bërë Haxherja, bashkëshortja e Profetit Ibrahim, për të gjetur ujë për djalëin e saj, Ismailin. Zoti e kishte shpërblyer me daljen e burimit të Zemzemit, një ujë i bekuar me vlere shëruese, që ne do ta pinim sa herë që shkonim në Xhaminë e Mesxhidu’l-Haramit.

Brenda një jave ne kemi shkuar disa herë në mënyrë të organizuar por edhe individuale për të falur namazet në Xhaminë e Mesxhidu’l-Haramit, duke ditur vlefshmërinë e madhe që kishte falja në këtë xhami. Profeti (a.s) kishte thënë: “Namazi që falet brenda territorit të Mesxhidu’l-Haramit është njëqindmijëherë më i bekuar, sesa çdonjeri nga namazet që falet në një xhami tjetër”.

Pas faljes së disa namazeve në Qabe në Xhaminë dhe ambientet e jashtme të saj, për disa ditë, filluan ritet e haxhit.

Natyrisht që lutja për familjen time, bashkëshortin dhe fëmijët zuri vendin kryesor të lutjeve. Një lutje të përsëritur dhe shumë të përmallshme kam bërë për vendin tim Shqipërinë dhe shqiptarët, por veçanarisht për Shkodrën dhe shkodranët e mij. “O Zot, begatoje Shkodrën, e cila ka vuajtur nga pushtuesit e huaj dhe qeverisjet e këqija të njerëzve të saj, ka vuajtur nga tërmetet, përmytjet etj. O Zot, drejtoji shkodranët që të ecin në rrugën e drejtë, pa vrasje e krime, korrupsione, e gjakmarrje! Ban, o Zot, që Shkodra të jetojë gjatë”!

Riti i parë fillonte më shkuarjen në Mina, 6 kilometra larg Mekës, dy ditë para Bajramit të Kurbanit, ku fjetëm për një natë në çadra, duke falur namazet e shkurtuara të 5 vakteve (me që ishim udhëtarë) dhe duke iu lutur Zotit. Pastaj shkuam në Arafat, ku ndenjëm gjithë ditën duke u lutur vazhdimisht.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk ka ndonjë ditë që është më me vlerë tek Allahu se dita e Arafatit. Allahu i Lartësuar zbret në qiellin e kësaj bote dhe lavdërohet me banorët e tokës ndaj banorëve të qiellit.”

Kurse në një transmetim tjetër thuhet: “Allahu i Lartësuar lavdërohet me ata që qëndrojnë në Arafat tek melekët dhe thotë: “O melekët e Mi, shikoni robërit e Mi, më kanë ardhur të pakrehur, të pluhurosur (nga rruga) dhe duke sakrifikuar.”

Ajo që mua më ka bërë shumë përshtypje ishte se para perëndimit të diellit shumë njerëz, kishin dalur nga çadrat, dhe luteshin me duart drejt qiellit. Ashtu bëra edhe unë. Ishte hera e parë që në natyrë po i drejtoja Zotit lutjet e mija, të m’i falte mëkatet, të më sillte një ngjallje shpirtërore, që të bëhesha më e mirë, më tolerante, në shërbim të njerëzve të vendit tim me bindje dhe besim tek i madhi Zot.

Me perëndimin e diellit shkuam në

Muzdelife, ku kemi qëndruar deri në mëngjes në qiell të hapur. Aty kemi mbledhur gurët për të gjuajtur shejtanin.

Në ditën e parë të Bajramit kemi shkuar në Mina dhe prej aty kemi ecur në këmbë drejt vendit të gjuajtjes së shejtanit, ku para gjuajtjes me shtatë gurë kemi thirrur “Bismilahi, Allahu Ekber”.

Gjuajtja me gurë e shejtanit, një rit i lidhur me Ibrahim (a.s), të cilit shejtani desh t’ia prishte vendimin në adhurimin ndaj Zotit, të bënte të mendosh se secili nga ne ka ndërhyrjen e shejtanit, i cili përpiqet për të lëkundur vendosmërinë në besimin ndaj Zotit, në veprimet tona për të bërë gjëra të mira. Prandaj ky rit të injektonte ndjenjën, që sa më larg shejtanit të rrimë, aq më afër do jemi pranë Zotit. Dhe gjuajtja sinjifikative tregon që njerëzimi ka nevojë sot më shumë se kurrë për një luftë kundër shejtanit, që po prish moralin e botës, po rrënon ndjenjat e pastra njerëzore, po injekton vese të këqija prandaj të jemi sa më lag tij.

Gjuajtja me gurë ka vazhduar edhe për dy ditë të tjera. Pas këtyre riteve, kemi bërë në Meke tavafin e Haxhit dhe Sa’jin, duke përsëritur sure dhe hadithe në adhurimin ndaj Zotit, lutje, duatë tona për të afërmit, familjarët, njerëzit që kanë vdekur, për popullin tonë deri sa emocionet na përshkonin gjithë trupin dhe mendjen, duke mos ndarë kurrë lutjen për pranimin e Haxhit nga Zoti i Plotfuqishëm.

MEDINA! Ky qytet i shenjtë, ku Muhammedi (a.s) emigroi dhe gjeti mundësinë e përhapjes së Islamit, ku zhvilloi betejat kundër idhujtarëve, do të rriste dimensionin e të Dërguarit në një shkallë të tillë, sa ai do të bëhej një nga personalitetet më të mëdha të njerëzimit. Personalisht, duke parë turmat disa milionëshe, që luteshin e luteshin, jam habitur se si i dërguari i Zotit, Pejgamberi (a.s), kishte arritur kulmin e admirimit të njerëzimit, si personaliteti më i madh i rruzullit tokësor, që njerëzimi jo vetëm që nuk e kishte harruar, por madhështia e tij edhe tashti pas më shumë se 1400 vitesh rritej e rritej në ndergjegjen e njerëzve për të mbetur burim frymëzimi në zemrat e tyre. Këtë e vura re në vizitën që bamë tek varri i tij në Xhaminë Mesxhidu’n-Nebevi, tek vendi i quajtur “Huxhretus Seadet”, ku mijëra gra qanin, luteshin për personalitetin e lavdishëm të tij dhe falnin namaz bri varrit të tij, duke u lutur që Zoti ta pranonte në xhenetin e praruar.



“PËRSHPIRTJE DHE NOSTALGJI NGA HAXHI 2015”, AKTIVITETI NË NDERIM TË HAXHILERËVE SHKODRANË

Paraditen e së shtunës, më 17 tetor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një tryezë përkujtimore, në nderim të haxhilerëve të këtij viti, emocioneve dhe përshpirtjeve të përjetuara prej tyre gjatë këtij udhëtimi të mrekullueshëm.

Aktiviteti nisi me fjalën e teologut Arben Halluni, që theksoi se kjo mirësi e madhe e Zotit ndaj haxhilerëve të Shkodrës, është një ftesë reflektimi për mirësitë e mëdha, me të cilat Ai e ka rrethuar jetën tonë dhe obligimin që kemi ndaj këtyre mirësive.

Takimi u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili uroi të gjithë haxhilerët e pranishëm për haxh të pranuar dhe përfitime shpirtërore, që do reflektojnë mirësinë dhe bukurinë e Islamit edhe në jetën e përditshme, këtu në Shkodër.

Myftiu uroi që kjo mirësi e madhe, të vazhdojë të rrezatojë përherë e më shumë vlera besimi dhe mirësi udhëzimi në Islam për popullin tonë, Shkodrën në veçanti.

Me shumë emocion u ndoq fjala e znj. Zenepe Dibra, e cila pati mirësinë e Zotit që të kryente haxhin e sivjetshëm. Ajo shprehu falënderimet e saj ndaj Zotit, që ia mundësoi ta kryente haxhin dhe të përjetonte emocione të mëdha, të cilat dëshiroi t'i ndante me të pranishmit dhe përtej tyre.

Znj. Dibra theksoi se gjatë qëndrimit në Mekë dhe Medinë, është lutur edhe për Shkodrën dhe Shqipërinë, që Zoti



ta mbrojë nga haramet, korrupsioni, e keqja, imoraliteti e shturja, si dhe ta udhëzojë popullin tonë drejt besimit dhe vlerave të tij.

Ajo falënderoi edhe Myftininë Shkodër për trajnimin dhe përkujdesjen e saj në përcjelljen dhe pritjen e haxhilerëve. Me këtë rast, i dhuroi Myftiut të Shkodrës, një kopje të vëllimit të parë librit të saj enciklopedik, titulluar: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”.

Aktiviteti vijoi me fjalën e mbajtur nga imami i nderuar, teologu Ruzhdi Plangaj, i cili tha se përjetimet e haxhit janë një eksperiencë e pashembullt dhe një mirësi e madhe, që të bën të mbetesh i lidhur me ato vende të shenjta, edhe pas kthimit në vendlindje.

Në fjalën e tij, ai tha se përkushtimi i haxhilerëve shqiptarë ka qenë i madh, njësoj si lutjet e tyre për vendlindjen dhe shqiptarët kudo janë.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, si dhe H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, që shprehën vlerësimet e tyre për këto organizime të dobishme dhe vlerësimin ndaj haxhilerëve të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

Në fund, imami i nderuar, z. Agim Hoxha këndoi një ilahi të bukur kushtuar haxhit dhe haxhilerëve, në nderim të këtij tubimi vlerash.

Për të pranishmit, Myftinia kishte organizuar edhe një ftesë për kafe dhe çaj.

← Xhamia e parë që ai ndërtoi në afërsi të Medinës ishte Xhamia e Kubasë, ku ne falëm dy rekate namaz. Ajo pranonte për t'u falur 13.000 mijë muslimanë. Kishte karakter historik, sepse atë e ndërtoi Muhammedi (a.s) si xhaminë e parë në emigrimin drejt Medinës. Por Xhamia Mesxhidu'n-Nebevi, brenda qytetit të Medinës, një vepër madhështore arkitekture dhe konstruktive, që plotëson të gjithë kriteret për një audiencë dhe falje namazesh të mijëra vetëve, aty ky filloi predikimi i fesë islame, do kthehej në një fener ndriçues për mbarë muslimanët e botës, ku falja e namazit ishte e një rëndësie të veçantë. Vetë Profeti (a.s) për këtë xhami do shprehesh: “Një namaz që falet në xhaminë time është më me vlerë se çdo

namaz tjetër, me përjashtim të namazit që falet në Qabe”. Ne falëm të gjithë vaktet e namazeve në këtë xhami për sa kohë qëndruam në Medinë.

Një vizitë afër malit të Uhudit, Kodrës së Shigjetarëve ku profeti kishte zhvilluar një betejë kundër idhujtarëve, si dhe varrezat e Uhudit, ku ndodheshin shumë sahabë, dëshmorë të kësaj lufte, do të plotësonin aspektin historik të përpjekjeve dhe të luftës që ai kishte bërë për të sjellur besimin në një Zot, larg besimeve të idhujve dhe kundra veseve të këqija të shoqërisë të asaj kohe. Dhe për të përfunduar pastaj edhe njëherë në Meke në Tafavin e Lamtumirës, ku riti i fundit të mbushte me shpresa se Haxhin do të na e pranojë i Madhi Zot, se nesër do jemi

më të përgatitur për të luftuar kundër të keqes, për të bërë përpjekje sa më të mëdha për të mirën, për besimin, për familjet, për vendin tonë dhe për triumfin e besimit islam në botë.

Vallë ky emocion i kryerjes së detyrimit për në Haxh, a do mund të më kthehet në devocion për t'u lidhur më shumë me Zotin? I jam lutur shumë Atij të më afrojë, të më falë qetësinë shpirtërore për t'u lidhur me Të. Kjo do i mbetet kohës, por detyrimi që kreu për të bërë Haxhin është një impenjim për të menduar gjatë se vetëm lidhja me të Madhin Zot mund ta shpëtojë njeriun nga mëkatet e mëdha, nga veset, nga të këqijat, duke i sjellur dobi, begati dhe qetësi shpirtërore çdo qenie njerëzore.

Shkodër, 5.10.2015

AKTIVITET I PËRBASHKËT MES NXËNËSVE TË XHAMIVE TË QYTETIT, BAHÇALLEK DHE KIRAS

Në kuadër të një projekti fetar dhe arsimor për afrimin e fëmijëve dhe të rinjve në xhami, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, ditën e diel, më 18 tetor 2015 ka organizuar në xhaminë e Bahçallekut një aktivitet arsimor me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare të xhamive Kiras dhe Bahçallek.

Aktiviteti filloi me fjalën përshëndetëse të teologut Arben Halluni, përgjegjës i arsimit dhe medias pranë Myftinisë Shkodër, ku dha mesazhe për t'u afruar sa më shumë në shtëpitë e Zotit (xh.sh), të cilat përçojnë vlerat e vërteta të besimit, moralin e pastër islam dhe frymën paqësore dhe të harmonisë, me të cilat duhet të pajiset çdo besimtar dhe më pas t'i përcjellë ato tek të gjithë njerëzit, si krijesa të dalluar të Krijuesit të gjithësisë.

Gjithashtu përshëndetën imamët e xhamive Kiras dhe Bahçallek, Ruzhdi Plangaj dhe Ademir Xama, të cilët gjatë



fjalës së tyre vlerësuan rëndësinë dhe vlerën mjaft të madhe që ka organizimi i llojshmërisë së aktiviteteve arsimore, me qëllim për të afruar brezin e ri në besimin dhe adhurimin e Allahut (xh.sh).

Më pas, sipas programit të aktivitetit u zhvillua një konkurs fetar mbi bazën

e njohurive islame mes nxënësve të dy xhamive. Fitues i këtij konkursi doli xhamia Kiras.

Në fund të aktivitetit të gjithë nxënësit u stimuluan me nga një dhuratë dhe bashkërisht falën namazin e drekës...

MYFTIU PRITI KRYETARIN E SHOQATËS "RIDA", NGA KONJA E TURQISË

Paraditen e së martës, më 20 tetor 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim prezantimi, një përfaqësi të Shoqatës "RIDA", me qendër në Konja të Turqisë, nën drejtimin e Kryetarit të saj, z. Tamer Kalender.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu uroi mirëseardhjen e vëllezërve nga Konja, duke theksuar se në Shkodër, ju nuk jeni miq, por vëllezër, sikurse ne, sa herë që vijmë në Turqi, vijmë në tokën tonë, pasi shekujt e kalifatit osman, ishin dëshmi historike sesi shqiptarët e turqit (por edhe shumë kombësi të tjera), ishin një mishërim i një kalifati, ndër më të qytetëruarit e shekujve të historisë islame.

Nga ana e tij, z. Kalender, e informoi Myftiun për aktivitetin e zgjeruar të kësaj shoqate në shumë vende të botës, sidomos në fushën e arsimit dhe përkujdesjes për jetimët. Ai tha se "RIDA" ka dëshirë të ketë aktivitetin e vet edhe në Shkodër, dëshirë për të cilën mori edhe miratimin dhe vullnetin e mirë të bashkëpunimit edhe nga Myftiu i Shkodrës.



Gjatë kësaj pritje, Myftiu dha edhe një intervistë të zgjeruar për Tv Konya, ku iu përgjigj pyetjeve të shumta të gazetarit në lidhje me aktivitetin e Myftinisë Shkodër, sfidat, pengesat, të ardhmen.

Gjatë kësaj interviste, Myftiu theksoi se stabiliteti dhe ecuria e Turqisë, është në vetvete stabilitet dhe përparim për

krejt ymmetin islam. Për këtë, ai u lut që Zoti ta ruajë Turqinë nga sfidat, me të cilat po përballet mbarë ymmeti islam, sidomos në zonat e nxehta të Lindjes së Mesme.

Delegacioni i Shoqatës "RIDA", shoqërohej edhe nga Kryetari i Shoqatës "Ihja", z. Jetmir Braqi.

KËSHILLI I MYFTINISË, TAKIMI PËRMBYLLËS NË PRAG TË 16 NËNTORIT



Mbrëmjen e së enjtes, më 22 tetor 2015, Këshilli i Myftinisë Shkodër, zhvilloi një takim këshillimor, ku u diskutua në mënyrë të detajuar programi i ngjeshur i aktiviteteve të muajit nëntor, në prag të datës historike të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, pas 23 vitesh persekutimi fetar në vendin tonë.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, shpjegoi rëndësinë që ka data 16 nëntor 2015, si një moment reflektimi mbi madhështinë e besimit dhe nevojën e vazhdueshme për të dhënë në rrugën e tij.


Ai tha se këtë vit, Myftinia Shkodër ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të vitit jubilar të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë në Shqipëri, xhamisë së Plumbit. Por, ai theksoi se vlera kryesore e

këtij angazhimi maksimal të krejt faktorëve të kësaj mbarësie hyjnore, përqendrohet tashmë në aktivitetet e larmishme të muajit nëntor 2015.

Këshilli i Myftinisë Shkodër, diskutoi për mbi dy orë, krejt programin e prezantuar nga Myftiu, duke dhënë mendime të dobishme, ide për arritjen e më të mirës në drejtim të përkujtimit sa më dinjitoz të kësaj ngjarjeje historike.

Programi i plotë i takimit të kësaj mbrëmje do të bëhet publik shumë shpejt, në një konferencë për shtyp.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër fton krejt besimtarët dhe qytetarët e Shkodrës, të bëhen pjesë e aktiviteteve në përkujtim të ngjarjes historike të rihapjes së xhamisë së parë, pas shtypjes dhe persekutimit të dhunshëm ateo-komunist.



"Nuk e di,
përse trazohet
një popull për
një disfatë
sportive dhe
nuk i rrëngethet
asnjë fije floku
për dështimet
e tij qytetërore,
industriale
dhe shoqërore"?

Shejkh Muhammed El-Gazali



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISE
MYFTINIA SHKODËR

KALENDARI I AKTIVITETEVE

ME RASTIN E 25-VJETORIT TË RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT, SHKODËR

(30 tetor -16 nëntor 2015)

30.10.2015

Hytbeja e xhumasë në të gjitha xhamitë e Shkodrës i kushtohet sakrificës dhe vullnetit të pashembullt të rinisë dhe qytetarëve shkodranë, që në nëntor të vitit 1990, i paraprinë proceseve demokratizuese të vendit, me hapjen e objekteve fetare.

1.11.2015

Ceremonia përkujtimore: "Mirënjohja e Qytetit", Myftiut të Shkodrës, H. Xhemal Çanga.
(aktiviteti zhvillohet në bibliotekën e qytetit, pranë xhamisë Parrucë, ora: 17.00 – ftesë e hapur).

2.11.2015

Aktiviteti përkujtimor: "Këshilla të një hytbeje, sa një amanet", kushtuar Myftiut të Shkodrës, H. Faik Hoxha.
(aktiviteti zhvillohet në kinema "Millenium", ora: 17.00 – ftesë e hapur).

3.11.2015

Bashkëbisedim me Myftiun e Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.
(aktiviteti zhvillohet tek salla e konferencave e konviktit të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", dega djem, ora 17.00 – ftesë e hapur).

4.11.2015

Inaugurimi i xhamisë së fshatit Mes-Myselim.
(ceremonia zhvillohet në orën 11.00).

5.11.2015

Inaugurimi i përfundimit të restaurimit të xhamisë në kalanë e Drishtit.
(ceremonia zhvillohet në orën 11.00).

6.11.2015

"Nostalgji dhe mall për Hoxhën tonë, Hafiz Sabri Koçi".
(aktiviteti zhvillohet në xhaminë e Rusit, në orën 12.00).

9.11.2015

Vizitë tek shtëpia e imamit të nderuar, Hafiz Sulejman Kraja.
(ora: 16.30. Myftiu me Këshillin e Myftinisë Shkodër).

10.11.2015

Inaugurimi i pllakatës tek ndërtesa e ish-Myftinisë Shkodër, pas vitit 1990.
(ora: 11.00. Shtëpia e familjes Baja, rruga e gjerë, pranë stadiumit).

11.11.2015

Vizitë tek shtëpia e familjes Myftija, lagjja "Tabakë", pranë xhamisë së Plumbit.
(ora: 16.30. Myftiu me Këshillin e Myftinisë Shkodër).

12.11.2015

Ekspozita e botimeve të hoxhallarëve, imamëve dhe thirrësve islamë shkodranë në 25 vitet e fundit dhe promovimi i librit **"Zidni"**, nga Imam Muhamed Sytari, *Myfti i Zonës Shkodër*.
(aktiviteti zhvillohet në bibliotekën e qytetit, pranë xhamisë Parrucë, ora: 17.00 – ftesë e hapur).

13.11.2015

E xhumaja masive për të gjitha xhamitë e qytetit, tek sheshi i xhamisë së Plumbit, në orën 12.00.
(për ata që nuk kanë mundësi qarkullimi me mjete personale, autobuzët në dispozicion nisen në orën: 11.30, pranë xhamisë së Parrucës).

14.11.2015

Konferenca: **"25 vjet liri besimi – sfida, sprova, perspektiva"**.
Referojnë: Dr. Genti Kruja, (drejtor i kulturës dhe dialogut ndërfaqetor, KMSH),
Msc. Anduena Qefalia (pedagoge, C.I.T),
Artur Tagani (Phd candidate, U.E.T),
Lavdrim Hamja (imam, Myftinia Shkodër)
(aktiviteti zhvillohet te salla e konferencave, te hotel "Colosseu", ora: 11.00).

16.11.2015

Inaugurimi i pllakatës tek shtëpia e familjes Myftija, (lagjja "Tabakë", ora: 11.00).
Falja e namazit të mesditës me xhemat dhe Duá për hoxhallarët dhe besimtarët e shkuar, ora: 11.30.
Shfaqja e dokumentarit kushtuar rihapjes së Xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990, në teatrin "Migjeni", ora: 17.00.
Përsëritjet protokollare.
Fjala përsëritëse nga **H. Skender Bruçaj**, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.
Program artistik i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", me ilahi dhe recitime.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org